Kjo marrëveshje është hartuar në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”; ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”; ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, i ndryshuar; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 93, datë 27.02.2019, “Për përcaktimin e tarifave dhe të pagesave për shërbimet ndaj institucioneve apo personave, që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”; statutit të Universitetit Politeknik të Tiranës; rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 12.02.2024, të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit; planit strategjik 2023-2028, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

V E N D O S I:

1. Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit për t’u nënshkruar me Universitetin e Politeknik të Tiranës, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ndjekjen dhe vazhdimin e procedurave për të vijuar me nënshkrimin e marrëveshjes.
3. Të ngarkojë Sekretariatit Teknik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Të ngarkojë Sektorin e Arkiv-Protokollit në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës, që të njoftojë këtë vendim.

Kryetare: Dr. Gentiana Sula

Anëtarë: Dr. Albert Nikolla, Gjergj Marku, Altin Hoxha dhe Skënder Vrioni.



KUJTESA DHE EDUKIMI QYTETAR

“MËSOJMË NGA E KALUARA 1944–1991” MERR MBËSHTETJE NGA ASCAP DHE PARTNERËT

Tiranë, më 6 mars 2026



U zhvillua një takim i rëndësishëm me partnerë ndërkombëtarë, ku diskutuam vijimin e punës për ndërtimin e platformës digjitale edukative “Mësojmë nga e kaluara – Burime arsimore të hapura 1944–1991”, e cila synon krijimin e një hapësire të strukturuar, të besueshme dhe të aksesueshme për edukimin mbi periudhën e diktaturës komuniste në Shqipëri dhe lidh në mënyrë të drejtpërdrejtë dokumentet arkivore me procesin e mësimdhënies dhe edukimin qytetar të brezit të ri.

Për Kryetarin e Prezencës së OSBE-së në Tiranë, z. Michel Tarran, si dhe për përfaqësuesit e Ambasadës së Gjermanisë, Këshillit të Evropës, ASCAP, MA, Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit (ISKK), u prezantua koncepti i detajuar i platformës, fazat e zhvillimit dhe nevojat për mbështetje, me qëllim mobilizimin e një bashkëpunimi sa më të gjerë për realizimin e kësaj infrastrukture digjitale edukative.

“Një element vendimtar është mbështetja e qeverisë shqiptare, e cila ka ndarë fonde të mjaftueshme për të nisur ndërtimin e infrastrukturës digjitale fillestare. Kjo na mundëson të kalojmë nga faza konceptuale në zbatim konkret dhe të avancojmë me ritëm të qëndrueshëm. Por sfida jonë mbetet e njëjtë me atë të shumë vendeve post-komuniste: të kapërcejmë historiografinë e vjetër ideologjike, të integrojmë narrativat personale të viktimave me fakte arkivore të verifikuara, dhe të krijojmë një tregim të hapur, të krahasueshëm me standardet evropiane”, tha kryetarja e Autoriteti Dosjeve, Dr. Gentiana Sula.

Gjatë takimit u diskutuan llojet e materialeve burimore dhe didaktike që do të jenë të përfshihen në platformë për këtë periudhë të historisë në ndihmë të nxënësve, mësuesve e studentëve të degëve të mësuesisë. Analiza e programeve të arsimit parauniversitar tregoi se historia e funksionimit të aparatit të diktaturës – sidomos e ish-Sigurimit të Shtetit – trajtohet në mënyrë të kufizuar në tekstet dhe kurrikulat aktuale. Shumë mësues të lëndës së historisë nuk e kanë përjetuar personalisht këtë periudhë dhe shpesh u mungojnë burime të strukturuar, të verifikuara dhe të përshtatura me formën e duhur për ta trajtuar plotësisht në klasë.

Dokumentet arkivore që ruajmë nuk janë thjesht dëshmi të së shkuarës; ato na ndihmojnë të kuptojmë mekanizmat e një sistemi që prodhoi padrejtësi të gjera dhe na orientojnë për të ndërtuar një kulturë më të fortë demokratike tek të rinjtë. Përmes platformës “Mësojmë nga e kaluara”, AIDSSH synon t’i transformojë këto dokumente në burime edukative të hapura, të cilat do t’u shërbejnë mësuesve, nxënësve dhe studiuesve për lexim kritik, analizë dhe reflektim mbi pasojat e ideologjisë totalitare, rëndësinë e drejtësisë dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut.



Ornella Arapi, Drejtore e Drejtorisë së Hulumtimit Shkencor dhe Edukimit Qytetar në AIDSSH e cila prezantoi projektin për të pranishmit theksoi se “platforma do të mbështetet në kontributin e një rrjeti të gjerë studiuesish dhe kërkuesish nga brenda institucionit dhe institucionet partnere, duke përfshirë edhe familjarë dhe dëshmitarë të drejtpërdrejtë të kësaj historie. Gjatë viteve të fundit kemi punuar në mënyrë të vazhdueshme për ta përgatitur këtë bazë bashkëpunimi

– nga procesi i digjitalizimit të dokumenteve deri te zhvillimi i materialeve edukative. Sot ky proces po merr një formë më të strukturuar dhe të bashkërenduar, me një orientim të qartë pedagogjik në bashkëpunim me Agjencinë Shqiptare të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP).”

Platforma do të ofrojë dy nivele kryesore akses: nivel profesional për mësues, studiues, autorë tekstesh dhe edukatorë, me materiale burimore, dosje tematike dhe mjete didaktike të avancuara dhe nivel për nxënës dhe të rinj, me përmbajtje të përshtatur pedagogjike, video, aktivitete interaktive, kuize dhe forma inovative të të nxënës përmes historisë.

Autoriteti fton të gjithë partnerët institucionalë, donatorët dhe aktorët e interesuar – vendas dhe ndërkombëtarë – të bashkohen në zhvillimin dhe mbështetjen e qëndrueshme të projektit, që platforma të shndërrohet në një mjet efektiv dhe afatgjatë për edukimin mbi demokracinë, të drejtat e njeriut dhe reflektimin kritik mbi të kaluarën totalitare.



AIDSSH NË MEDIA

Tiranë, 17 mars 2026

Vrasjet në kufi gjatë viteve '89–'90

“Për ata që mendojnë se ishte ligji i kohës të paktën moralisht sot, të kërkojmë ndjesë dhe të përpiqemi t’ia lehtësojmë sa më shumë dhimbjen që kaloi. Kurse për atë pjesë që edhe legjislacioni i kohës e ndaloi vrasjen në kufi, aty drejtësia duhet të funksiononte dhe duhet të funksionojë”, është shprehur kryetarja e AIDSSH-së znj. Gentiana Sula gjatë një dokumentari të realizuar nga BIRN dhe Kujto.al, dokumentar i cili rikthen në vëmendje njërën nga kapitujt më të errët të historisë sonë të afërt: vrasjet në kufi gjatë viteve '89–'90, ku dhjetëra qytetarë humbën jetën në përpjekje për t’u larguar nga vendi. Përtej rrëfimit të tragjedi individuale, dokumentari ngrre një pyetje thelbësore që mbetet ende pa përgjigje: Pse drejtësia mungon edhe sot?

AIDSSH: TË DHËNAT E PERSONAVE TË ZHDUKUR NË REGJIMIN KOMUNIST NË PLATFORMËN NDËRKOMBËTARE IDMS

Tiranë, 17 mars 2026

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) ka vënë në funksion një instrument të ri për familjarët e personave të zhdukur gjatë regjimit komunist: platformën online të kërkimit (Online Inquiry Center – OIC), të zhvilluar në bashkëpunim me Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP).

Për herë të parë, familjarët mund të raportojnë raste të reja, të kërkojnë nëse një person rezulton në sistem, të dërgojnë dokumente shtesë dhe të sinjalizojnë vendndodhje të mundshme të varreve, të gjitha këto përmes një mjeti të sigurt dhe lehtësisht të përdorueshëm.





Kjo platformë është pjesë e reformimit të gjerë institucional që AIDSSH ka ndërmarrë gjatë viteve të fundit, ku përfshihet edhe integrimi në sistemin e avancuar të menaxhimit të të dhënave (iDMS). Sistemi u finalizua në mars 2026, pas përfundimit të integrit të databazës kombëtare për personat e zhdukur, të ndërtuar mbi të dhënat e mbledhura nga vitet 2017–2025.

Bashkëpunimi me ICMP-në, i mbështetur në marrëveshjen e ratifikuar me ligjin nr. 83/2018 dhe i formalizuar së fundmi me Marrëveshjen e Përdoruesit Fundor (EULA), ka forcuar sigurinë dhe standardizimin e informacionit mbi rastet e personave të zhdukur.

Ky zhvillim shënon një hap domethënës për qasjen e familjarëve në informacion dhe për përpjekjet institucionale drejt zbardhjes së fatit të personave të zhdukur gjatë regjimit komunist në Shqipëri.

Platforma OIC është e aksesueshme në: https://oic.icmp.int/index.php?ë=mp_details&l=al

ICMP KONFIRMON MBETJE MORTORE NË 6 VENDVARRIME TË DYSHUARA, AIDSSH: KËTO JANË PROVA TË FORTA PËR HETIM

Tiranë, 31 mars 2026

Kërkimi për të zhdukurit në Shqipëri po hyn në një fazë më të avancuar – por edhe më kërkuese për vendimmarrje. Në përmbyllje të projektit AIDSSH–ICMP, Kryetarja e Autoritetit të Dosjeve, Gentiana Sula, deklaroi se tashmë ekziston një bazë më e plotë provash dhe dokumentimi, që duhet të kalojë në duart e drejtësisë.



“Këtë herë kemi një ndryshim thelbësor: prova më të plota, dokumentim më të strukturuar dhe një bazë më të fortë për hetim,” - u shpreh ajo, duke kërkuar që Prokuroria të marrë në shqyrtim gjetjet.

Aktualisht, AIDSSH po avancohet në verifikimin e 17 vendvarrimeve të dyshuara, ndërsa në 6 prej tyre ICMP ka konfirmuar praninë e mbetjeve mortore përmes metodave shkencore – një zhvillim që konsiderohet si provë e fortë për vijimin e hetimeve. Paralelisht, është ndërtuar dhe konsoliduar databaza për personat e zhdukur, ku deri më tani janë regjistruar rreth 410 raste, të mbështetura në kërkesat e familjarëve dhe verifikimet institucionale. Kjo databazë përbën bazën kryesore për hetim, identifikim dhe bashkëpunim ndërinstitutional.

Në hapje të aktivitetit, përfaqësuesja e ICMP, znj. Samira Krehic, theksoi se projekti ka vendosur themelet e një procesi të qëndrueshëm dhe në përputhje me standardet europiane, por paralajmëroi se mijëra familje vijojnë të presin përgjigje dhe se kjo mbetet një përgjegjësi e hapur e shtetit.

Anëtar i Autoritetit, z. Gjergj Marku, theksoi nevojën për një koordinim real dhe të detyrueshëm ndërinstitutional, në mënyrë që puna e bërë të mos mbetet e fragmentuar. Z. Vrioni, anëtar i AIDSSH, theksoi qartë se pa rregullime ligjore dhe miratimin e akteve nënligjore, procesi rrezikon të ngecë, pavarësisht progresit të arritur. Theksin e angazhimit më aktiv i strukturave të drejtësisë, duke e konsideruar këtë si momentin për të kaluar nga dokumentimi në veprim konkret, e vuri anëtar i AIDSSH, z. Altin Hoxha.

Ndërsa z. Albert Nikolla vlerësoi analizën antropologjike të ICMP-së si thelbësore për identifikimin e mbetjeve mortore.

Në thelb, mesazhi i këtij takimi ishte i qartë: është ndërtuar një bazë serioze pune, por hapi vendimtar nuk është më teknik, është politik dhe institucional.

Nga ICMP për Shqipërinë, koordinatori i saj, Luigj Ndou, shprehu gatishmërinë e organizatës për të qenë në krah të qeverisë shqiptare dhe për të mbështetur procesin me ekspertizë teknike, por theksoi se ndërmarrja e hapave konkretë dhe vendimmarrja mbetet përgjegjësi e institucioneve shqiptare.

Juristja e njohur dhe përfaqësuese e shoqërisë civile, Erinda Bllaca, vlerësoi përpjekjet e AIDSSH-së dhe deklaroi se kërkohet vendimmarrje e qartë politike dhe institucionale për ta çuar procesin përpara.

Pa vendime të qarta, pa koordinim të plotë dhe pa kuadër të konsoliduar ligjor, edhe provat më të forta rrezikojnë të mbeten pa përgjigje. Ndërkohë, familjet vazhdojnë të presin.



AIDSSH: 410 PERSONA NË KËRKIM NGA FAMILJARËT

Tiranë, 6 prill 2026

Raportet e detajuara të hartuara nga ekspertët e ICMP-së do të jenë pjesë e dokumentacionit që do t'i dorëzohet prokurorisë për të marrë lejen e gërmimit në këto vendvarrime.

Janë të paktën 5 vendvarrime ku ka dyshime të forta se gjenden eshtrat të personave të zhdukur gjatë regjimit komunist. Hetimet e Autoritetit për Informimin mbi Dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit, kanë gjetur konfirmim dhe nga zbatimi i teknologjive të avancuara. Për Report Tv, Autoriteti zbulon dhe emrat e personave të identifikuar të varrosur në to. Mes personave të cilëve nuk u gjenden eshtrat Autoriteti ka regjistruar rreth 410 raste.

Në mjediset e Autoritetit për Informimin mbi Dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit ndodhet një hartë e Shqipërisë, ku janë vendosur shenja për çdo raportim të familjarëve, shoqatave apo veprimtarëve të kujtesës për vendvarrime të dyshuara, vendekzekutime ose vende ku mendohet, përmes rrëfimeve të dëshmitarëve okularë, se ka mbetje mortore.

Autoriteti po kryen verifikime për 17 vendvarrime të dyshuara, ku të dhënat nga familjarë, të cilët kanë ofruar edhe materiale gjetetike, janë ndërthurur edhe me dokumente të kohës.

Ndërsa, falë bashkëpunimit me ekspertë antropologë, arkeologë dhe njohës të fushës nga Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP), për të paktën 5 raste probabiliteti për gjetjen e eshtrave është shumë i lartë.

“Bëhet fjalë për vendvarrimin e Rrmajit në Shkodër. Bëhet fjalë për dy vendvarrime pothuajse të konfirmuara, që do të konfirmohen 100% kur të bëhen gërmime në kishën e Shpalit dhe në Spaç të Mirditës, ku mendohet që janë varrosur katër heronjtë e revoltës së Spaçit. Bëhet fjalë për malin e Gramozit, në Shel Gurë, ku është një qytetar i cili është vrarë në tentativë për të kaluar kufirin. Bëhet fjalë edhe për një vendvarrim në Himarë, në Shën Vasil.”, thotë drejtuesja e AIDSSH-së, Gentiana Sula.

“NJË KRIM QË VAZHDON”: AUTORITETI ÇON PROVA TË REJA PËR TË ZHDUKURIT NË 5 PROKURORI

Tiranë, 16 prill 2026

Intervista e plotë e Dr. Gentiana Sula, Kryetare e Autoritetit të Informimit mbi Dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit në televizionin e News 24

Fatmira Nikolli (News24): Nëntë vite më parë, shteti shqiptar themeloi Autoritetin e Informimit mbi Dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit. Synimi parësor ishte që, përmes leximit, studimit dhe hapjes, publikimit, qytetarët shqiptarë, sidomos ata që kanë qenë objekt ose subjekt i dosjeve, të mësonin jo vetëm historinë e tyre, por që edhe ne të gjithë të mësonim historinë e Shqipërisë.

Në këto nëntë vite, përveç ekspozitave, aktiviteteve dhe punës që është bërë në Autoritetin e Dosjeve për informimin e atyre njerëzve që janë survejuar nga ish-Sigurimi i Shtetit, një punë e madhe është bërë edhe për kërkimin e eshtrave të të zhdukurve në diktaturë. Një pjesë e madhe e të cilëve janë zhdukur, vdekur ose ekzekutuar në vende të ndryshme gjatë jetëgjatësisë së sistemit komunist në Shqipëri. Por trupat e tyre nuk iu janë dorëzuar familjeve dhe ka pasur kërkime të gjata dhe është bërë një punë e madhe pikërisht për të mundësuar që eshtrat e tyre të kërkohen ligjërisht. Bashkë me kryetaren e Autoritetit të Dosjeve, zonjën Gentiana Sula, do të flasim pikërisht për të zhdukurit në Shqipëri dhe punën që është bërë për kërkimin e tyre edhe nëpër dokumente.

Zonja Sula, çfarë ka bërë Autoriteti në këto 9 vite punë intensive për gjetjen e këtyre njerëzve të pafat, të vrarë nga shteti?

Dr. Gentiana Sula: Ju falënderoj që vazhdoni interesin mbi këtë temë, që duket sikur i përket të shkuarës, por çështja e të zhdukurve është edhe çështje e së tashmes.

Ju e thatë bukur që Autoriteti ka nëntë vjet që është krijuar dhe një ndër arritjet kryesore që mendoj se i ka dhënë vlerë çdo pune që bëjmë, është grumbullimi i arkivit. Ka qenë një sfidë jo e vogël me karakter administrativ dhe menaxherial, sepse bëhet fjalë për një pjesë të madhe të arkivit që ka qenë sekrete: të shkëpusje dokumentet nga Shërbimi Informativ Shtetëror ose Ministria e Punëve të Brendshme dhe të krijoje këtë strukturë natyrisht ishte një sfidë e madhe.

Këto materiale janë mbledhur në mënyrë sekrete, pa dijen e personit dhe me qëllimin për t'i bërë keq. Për të gjitha këto arsye, ato kanë implikime të forta etike e morale edhe kur jetojnë njerëzit dhe kur nuk jetojnë, sepse edhe vetë viktimat dhe ata nuk duan të përfliten. Nuk është kollaj të thuash “Hapini, nxirrini!”, por ligji ka bërë një gjë të mirë dhe ne mendoj se e kemi zbatuar në të gjitha rastet: ai nuk mbron privatësinë e zyrtarëve dhe bashkëpunëtorëve të fshehtë.

Janë dëshmitarë, mijëra qytetarë që janë shërbyer. Çdo qytetar ka marrë dosjen e tij pa u fshirë emri i zyrtarit, hetuesit, prokurorit, gjykatësit, operativit apo bashkëpunëtorit që ne sa mundemi i zbardhim. A jemi gjithmonë të suksesshëm në zbardhjen e bashkëpunëtorëve? Jo gjithmonë. Ka shumë arsye, por përpjekja bëhet e plotë. Protokollet janë të shpallura, dihet se si bëhet kërkimi.

“Një ndër gjërat e rëndësishme me të cilën njerëzit kanë ardhur që në fillim ka qenë pikërisht qetësimi lidhur me fatin e të zhdukurve. I zhdukuri s'ka gojë, nuk është prezent, ka ikur në mënyrë të dhunshme, pa dijen e familjes, pa u informuar familja, pikërisht për terror, pikërisht për ta shtypur familjen. Kështu që ata kanë ardhur të parat dhe na kanë sjellë informacione shumë të vlefshme.”

Ka qenë një betejë e jona me veten: deri ku shkon institucioni, çfarë duhet të bëjë, deri ku shkon një arkiv si i yni, sa mund t'i ndihmojmë familjeve. Dhe kemi bërë hapat tanë për të krijuar një kuadër ligjor më fleksibël për t'i dhënë institucionit më shumë hapësira. Dhe këtë informacion që familjet vinin e sillnin ta verifikonim përmes hetimit administrativ, duke shkuar përtej arkivës sonë, bënim kërkime për familjet.



Në vitin 2022 Kuvendi na dha disa kompetenca shtesë, si: të bënim hetime administrative, të lidheshim me institucionet vendore për të referuar vendvarrimet e dyshuara dhe për t'i ruajtur ato, për të detyruar institucionet, përmes marrëveshjeve, të mbronim dhe vinim në lëvizje gjithë strukturat e drejtësisë si policia shkencore dhe mjekësia ligjore që të bënin punën e tyre, në rastet kur ndodhte gërmimi.

Fatmira Nikolli (News24): Ju së fundmi keni pasur një projekt bashkëpunimi me Komisionin Ndërkombëtar për Gjetjen e të Zhdukurve (ICMP) një strukturë ndërkombëtare që kërkon e gjen viktime edhe të masakrave të mëdha dhe gjenocideve dhe në rastin e Shqipërisë, do të duhej të ishte shumë më e lehtë për të gjetur të zhdukurit, sepse një pjesë e tyre gjenden rreth burgjeve ku kanë vuajtur dënimin të dënuarit politikë. Çfarë keni mundur të realizoni përmes punës me ICMP? Janë 17 vendvarrime të dyshuara dhe 6 ku ka pasur konfirmime po themi, të mbetjeve mortore. Si ka qenë puna me ICMP dhe cilat janë rezultatet e saj?

Dr. Gentiana Sula: Siç e thatë, ICMP është institucion ndërkombëtar i krijuar me rastin e luftës në ish-Jugosllavi. Është një arritje e madhe që ICMP ka shprehur interes të punojë me Shqipërinë, dhe kanë bërë një marrëveshje me qeverinë shqiptare që në vitin 2018.

Mendoj që gjithë përpjekja e shumë dekadave, e familjeve dhe e institucioneve të kohërave të ndryshme përmes angazhimit të ICMP-së merr kuptim, vërtetësi dhe efikasitet. Imagjinoni një familje që ka gërmuar diku ku gjenden mbetje mortore. Si e vërteton që është familjari i tij? Ka shumë elementë pasaktësie. Ose

imagjinoni që kemi raste familjarësh të cilët kanë gërmuar në vende të ndryshme ku u është thënë, me shpenzimet e veta, dhe janë vënë edhe në konflikt me ligjin. Në vitet e para ku vendet kanë qenë më të qarta dhe ka pasur dëshmitarë okularë gjallë, në vitet '90 ka ndodhur mjaft gërmime të nisura nga familjarët.

Projekti që u përfundua dje kishte të bënte pikërisht me ndihmën që do t'i jepej Autoritetit për sa kohë ne kemi mandat ruajtjen e vendvarrimit, përmes bashkëpunimit me pushtetin vendor. Ne bëmë hetimet tona me karakter arkivor deri më parë por, sa i përket vendit, përveçse të shqyrtonim rrëfimet e personave të ndryshëm dhe t'i rendisnim këto dëshmi, mbetje dyshimi: a është apo s'është vërtet dikush atje nën tokë?

ICMP na solli ekspertizën e vet me këqyrjen e antropologëve, arkeologëve dhe metodave joinvazive: skanerë dhe radarë të avancuar, të cilët na tregojnë me mundësi shumë më të madhe nëse vërtet vendi është i tillë. Siç e thatë, janë 17 vende që ne po hetojmë. Hetimi ynë është i gjerë, sepse lidhet me qartësimin e fatit, me figurën historike, me kontekstin historik. Çdo emër është futur në bazën tonë të të dhënave. Por sa i përket vendit, në 6 vende përmes ICMP-së u bë ky hetim dhe në 5 vende konfirmohet se mund të ketë mbetje mortore. Kjo sjell prova shtesë me karakter shkencor, të cilat shpresojmë të jenë të pakundërshtueshme dhe të kenë vlerë ligjore, për institucionet e tjera që të avancojnë punën deri te leja e gërmimit. Shpresojmë që ky të jetë një gjë që ata ta marrin parasysh.

Institucioni ka qenë aktiv. Çdo e dhënë që na ka ardhur ua kemi përcjellë policive vendore dhe prokurorive vendore, por ato e kanë gjetur materialin të paplotë, sidomos nga ana ligjore. Tashmë po u japim prova edhe më të forta. Shpresojmë shumë që përmes këtyre të avancohet drejt lejeve të gërmimit.

Fatmira Nikolli (News24): Ju, në fakt, keni kërkuar prokurorisë të vërë në punë këto prova. Tani, me prova të reja, si do të vazhdohet?

Dr. Gentiana Sula: Do t'i çojmë tek pesë prokurori vendore. Mbetet për t'u parë si do t'i analizojë secila. Do t'i çojmë dhe Ministrisë së Brendshme. Do të vijojmë t'i flasim publikut dhe ta ndërgjegjësojmë për procesin.

Do mbetet për t'u parë si do të ecë, por në praktikën ndërkombëtare dhe kjo na vjen përmes ICMP gjithmonë është

prokuroria që verifikon provat dhe vë në lëvizje institucionet për të bërë gërmimet, për të avancuar me identifikimin, rekuperimin dhe dhënien familjes.

Fatmira Nikolli (News24): Me aspektin ligjor të dyshimit të mbetjeve mortore të paidentifikuara?

Dr. Gentiana Sula: Imagjinoni tek Varrezat e Rrmajit në Shkodër, besoj keni qenë, atje ne kemi rreth 13 persona që kërkohen aktivisht nga familjet. Por gjetjet, përmes hetimit administrativ dhe hetimit joinvaziv të ICMP-së, tregojnë se ka shumë më shumë se aq.

Fatmira Nikolli (News24): Flasim për bregun e lumit?

Ngjitur me varreza e Rrmajit. Çfarë pretendimesh ka aty? Pronari i tokës kërkon ta zhvillojë zonën. Vetë shërbimet funerale të qytetit, ajo është dhe një varrezat monumentale, tentojnë të zgjerohen, sepse kanë nevojë për territor. Ka presion për zhvillim. Çfarë do të ndodhë do të zhvillohen mbi eshtra apo do të bëjnë gërmimin. Do t'i nxjerrin eshtrat, deri sa të identifikohen merren mostra ADN-je, matrikulohen dhe mbahen në një vend të sigurt e të denjë. Thirren familjet për të dorëzuar materialin gjenetik, që të bëhet identifikimi. Është e mundshme. Por trualli duhet të lirohet nga këto që të zhvillohet.

Është e drejta e pronarit, e drejta e kishës, e drejta e varrezës të zgjerohet nuk ka pse të mos zhvillohet, por ky është vetëm një rast, ka edhe raste të tjera. Së pari t'i ruajmë nga zhvillimi mbi to se ka raste të tjera ku është ndërtuar godinë, ka banesa mbi to. Minimumi që duhet të ndodhë është: të mos keqtrajtohen këto mbetje, të hiqen, të merret mostra, të vihen në një vend të denjë pranë shërbimeve të morgut dhe mjekësisë ligjore, të matrikulohen, të thirren familjet, matrikulohen edhe ato, bëhet identifikimi dhe pastaj mbetjet u jepen familjeve për varrim. Është e mundur.

Fatmira Nikolli (News24): Keni krijuar një hartë fillimisht nga rrëfimet e familjarëve të cilët, gjithë këtë periudhë, kanë pyetur për vendin e mundshëm ku familjari i tyre është varrosur pas ekzekutimit ose pas vdekjes në burg. Bashkë me ICMP-në, mbi këtë hartë është punuar për të konfirmuar mbetje mortore. A mund të na flisni pak për këtë hartë të zhdukurve të Shqipërisë?

Dr. Gentiana Sula: Harta, siç e thatë, është ndërtuar dhe e kemi vënë edhe në Google Maps. Por janë rrëfime, vendet janë pak a shumë rreth burgjeve, rreth kampeve, rreth vendeve të hetuesisë, por edhe në vende krejtësisht të çuditshme siç është, për shembull, rasti i Spaçit, në Shpal, ku mendohet dhe është konfirmuar se ka mbetje mortore. Mendohet se janë 4 heronj të revoltës së Spaçit. Është një vend afër kishës, ku s'ka pasur kishë atëherë. Ka plot vende të tilla, të zgjedhura pikërisht për të mos u gjetur.

Përmes kërkimit arkivor, këtu e atje ka ndonjë hartë që ne e kemi gjetur, por përgjithësisht kjo pjesë ka qenë e vështirë. Ne kemi pritur të gjenin harta të tilla, sepse çdo ekzekutim në fakt ka një procesverbal dhe ne disponojmë dokumentacion të tillë, por jo për çdo rast.

E dyta janë shërbimet funerale. Shpeshherë edhe në praktikat e Evropës Lindore janë varrosur, sidomos personat që kanë qenë nën dënim: pranë hetuesive, pranë spitaleve se ka dhe ata që kanë vdekur në spital për shkaqe shëndetësore, zakonisht vendoseshin në varre të pashënuara pranë varrezave të zonës. Shërbimet funerale i dinë ku i kanë, kanë lista dhe kjo është një punë e madhe që ne po e bëjmë.

Me këtë rast në Autoritet është miratuar dhe publikuar udhëzimi për qartësimin e fatit dhe të gjitha hallkat, mënyrat si mblidhen provat, domethënia e provave dhe ku kërkohet janë listuar atje. Mund të jenë pranë vendeve të vuajtjes ose në vende ku kanë dashur të fshihen edhe në zonat kufitare, por gjithmonë është dikush që ka qenë i pranishëm gjatë ngjarjes. Shpeshherë mungon dokumenti, por ka edhe raste ku disponojmë harta pra nuk është se ka pak informacion.

Fatmira Nikolli (News24): A ka pasur persona që kanë qenë pjesë e grupeve të ekzekutimit dhe kanë ofruar ndihmën e tyre?

Dr. Gentiana Sula: Tek ne deri tani jo, por tek familjarët kemi pasur raste. Shumë i rëndësishëm ka qenë rasti i Nikolin Kurtit, i cili e ka mbledhur dokumentacionin, ka takuar personat e përfshirë, ka gjetur dokumentacion dhe ka pasur edhe kërkesë ndjesë nga personat e përfshirë në proces. Prandaj familjarët janë të pazëvendësueshëm në këtë proces.

Fatmira Nikolli (News24): Për vështirësitë ligjore që ka gërmim. Pra edhe në këto 5 vendvarrime që së bashku me ICMP-në është konfirmuar që ka mbetje mortore nuk nisin dot gërmimet, pse? Ka vite që është punuar për një VKM që në fakt bashkërendon punën e një sërë institucioneve të Autoritetit, të policisë, të policisë shkencore, të bashkive, të prokurorive që në fund një bashki të japë urdhrin që të nis gërmimi, zhvarrimi dhe identifikimi. Pse rezultojnë kaq e vështirë të kërkohen njerëz që i kanë dhënë jetën këtij vendi, të cilëve u është marrë pasuria, u është shkatërruar familja, kanë bërë punë të papaguar ose të paguar keq dhe prapë nuk gjendet një mënyrë ligjore për të kërkuar njerëz që nuk do të tregojnë më dot çfarë kalvari kanë kaluar, çfarë u është marrë, kush i ka rrahur, kush i ka vrrarë. Apo është pikërisht kjo frika?

Dr.Gentiana Sula: Për mendimin tim, çdo rast është më vete. Diku mungon informacioni i saktë. Që të vesh në lëvizje institucionet e drejtësisë, duhet të kesh prova dhe nuk është e lehtë. Tashmë, me arritjet e fundit, do t'i vëmë në provë dhe do të shikojmë.

Do të kishte qenë e mirë të adoptonim praktikat ndërkombëtare p.sh. rastin e Polonisë, ku mendojmë se ka një praktikë institucionale që mund të vlejë edhe këtu. Ata kanë një ligj të posaçëm, ku e gjithë puna është brenda institucionit. Institucioni homolog i Autoritetit atje është ngarkuar përmes një ligji të posaçëm për gjetjen dhe identifikimin e trupave nga çdo periudhë qoftë: lufta, pasluftë, komunizmi. Kjo mund të jetë një qasje edhe për ne. Deri tani, ne kemi pasur propozimin bashkë me tryezën teknike me institucionet përmes një VKM-je, ku institucioneve u caktoheshin detyra dhe ne vihem në rol koordinues. Kjo VKM e "maksimalistit" na është kthyer nga dy ministritë Brendshme dhe Drejtësia dhe na thonë: "Rrini tek pozicioni juaj. Mblidhni informacion, qartësoni fatin, siguron ruajtjen e vendvarrimit, hallkat e tjera nuk janë detyra juaj."

Ne nuk jemi dakord me këtë dhe e kemi shprehur. Por kemi përpunuar një VKM që rri brenda kufijve të institucionit tonë, sepse nuk duam të humbasim kohë, duam të avancojmë sadopak. Gjithsesi, institucionet e tjera që duhet të marrin pjesë për të bërë një qasje ligjore që me marrëveshjen me ICMP-në të ketë një qëllim më të gjerë të fusë AIDSSH si palë, pasi ne nuk jemi palë, ose përmes ligjit tonë, ose me një ligj të posaçëm të vihen atributë më të forta që institucioni jonë të ketë pushtet ndër institucioneve të tjera, por do t'i tentojmë edhe ato.

Gjithsesi, nuk më pëlqen të flas për të pamundurën, sepse si proces është i mundur, por merr kohë. Është një temë relativisht e re mund të kujtojmë kohën kur njerëzit thoshin: "s'ka pasur të zhdukur në komunizëm", nuk njihnin konventën, nuk njihnin përkufizimet.

Do të doja të flisja për të mundurën, dhe natyrisht u bëj thirrje shoqërisë dhe institucioneve: të mos humbasim kohë. Informacionet e reja po mblidhen, shanset janë gjermimi të bëhet, mbetet për t'u vënë në provë tek 5 prokuroritë lokale.

Fatmira Nikolli (News24): Cilat janë këto 5 vendvarrime të dyshuara? Sa persona mendohet se gjenden aty?

Dr.Gentiana Sula: Ju fola për Varrezat e Rrmajes në Shkodër. Aty ne kemi 13 familjarë që kërkojnë të afërmit e tyre. Është rasti i Jup Kazazit, birit të Hamz Kazazit. Ai ka bërë gjermime vetë dhe e ka gjetur, por e ka mbyllur me idenë që të lërë institucionet të bëjnë punën. Ne kemi 13 familjarë. Ka klerikë kishe dhe figura të rezistencës antikomuniste të viteve të para. Ka qenë një vend ekzekutimi aty kështu që historia lidhet me rezistencën e armatosur të kohës, armiq të politikë, kryengritjen e Postribës dhe pjesë që ata e lidhin me Postribën. Ka shumë punë dhe për kontekstin dhe për figurat, janë disa klerikë, emrat e të cilëve i kam këtu, dhe mendohet se janë shumë më tepër se aq. Gjithë dëshmitë historike janë shumë më tepër, por ne përqendrohemi tek aplikimet që familjarët kanë bërë, sepse kjo është rruga që çon drejt identifikimit të pagabueshëm.

Në Spaç ka dy vendvarrime të konfirmuara: brenda burgut të Spaçit dhe në Shpal, ku është kisha, ku mendohet se janë katër heronjtë e Revoltës së Spaçit.

Në Shën Vasil, në Gramoz, vend ku tentohet kalimi i kufirit. Zotëria aty, Dhimitër Kono, është një person i vrarë gjatë tentativës për të kaluar kufirin edhe ai është një vend i konfirmuar.

Kemi vendosur 12 tabela në vendet e dyshuara që është hapi i parë në bashkëpunim me bashkitë, që të paktën këto të mos tjetërsohen dhe njëkohësisht do të vëmë në lëvizje procesin për gjermim.

Fatmira Nikolli (News24): Në fakt, kërkesa për gjetjen e të zhdukurve ka qenë një kërkesë e vazhdueshme edhe e Bashkimit Europian e cekur, nëse nuk gaboj, edhe në raportin e progresit para 1-2 vitesh si mungesë e respektimit të të drejtave të njeriut, edhe kur këta njerëz janë të vdekur. Çfarë mund të bëjë shoqëria, jo vetëm Autoriteti, për ta nxitur këtë proces?

Personalisht e shoh të pabesueshme sesa e vështirë është të gjermosh dhe të gjesh eshtra njerëzish që duan thjesht një varr ku të prehen, një varr i njohur nga familja. Dënimi i tyre, në shumë forma, vazhdon, përderisa ata nuk janë dorëzuar kurrë familjes dhe familja vazhdon të kërkojë e të presë.

Dr.Gentiana Sula: Ka shumë që mund të bëhet. Autoriteti do të vazhdojë punën, do të bëjmë propozimet tona për ta zhbllokuar pjesën burokratike dhe lehtësuar procesin. Do vazhdojmë të ndërtojmë partneritet ndërkombëtar, me ICMP-në do mundohemi të mbetemi partnerë, BE do të mundohemi ta mbajmë partner, sepse janë procese të vështira dhe të kushtueshme ndërkombëtare.

Sa i përket Autoritetit do të vazhdojmë kontaktin me familjarët, do vijojmë me simpoziumet për kufirin, do të vazhdojmë ta përkujtojmë Ditën e të Zhdukurve, do të vazhdojmë të jemi aktivë duke mbledhur informata dhe dëshmi.

Kushdo që ka informacion ta sjellë! Gjërat janë online. Ne ruajmë konfidencialitetin, të garantuar me ligj. Nuk bëhet fjalë të ekspozojmë burimin, por do të ishte shumë e udhës që kushdo që di diçka, çfarëdolloj gjëje, ta sjellë. Familjarët e të

zhdukurve vazhdojnë e vijnë, dhe unë gjej rastin t'i falënderoj që nuk e kanë humbur shpresën dhe janë këmbëngulës në të drejtën e vet. Duhet pikërisht të mos e humbin shpresën, nëse e humbin, nëse e lënë, do të "flejë" si temë, dhe kjo është edhe tema e tyre.

Çdo institucion shtetëror ka shumë për të bërë. Shqipëria ka detyrime nga Konventa Kundër Zhdukjeve me Forcë. Çdo vit Shqipëria raporton në OKB. Institucionet duhet ta kuptojnë që kjo është një çështje që nuk do të largohet nga tryeza ndërkombëtare as me OKB-në, as me BE-në. "Një Shqipëri që i gjen të zhdukurit e vet është një Shqipëri më afër Evropës."

Edhe fshehja e trupit, kushdo që ka dijeni dhe nuk e tregon përbën krim. Është shkelje penale. Fshehja e trupit në këto raste është krim i vazhduar. U bëj thirrje: Sa më parë, mos kenë frikë ta sjellin. Konfidencialiteti ruhet. Do të çlirohen nga një barrë njerëzore, do të bëjnë një vepër humanitare.

Fatmira Nikolli (News24): Të dhënat e mbledhura nga bashkëpunimi me ICMP-në ju kanë shkuar prokurorive?

Dr.Gentiana Sula: Po, jemi duke bërë vlerësimin tonë. Po shqyrtojmë çdo provë si ato që kemi mbledhur ne, ashtu edhe ato të ICMP-së dhe brenda muajit prill do t'i dërgojmë prokurorive. Prokuroritë janë ato të Lezhës, Shkodrës, Shën Vasilit (Sarandë), Erseka... dhe shpresojmë që secila t'i shikojë rastet e veta.

Një ndër gabimet që mendoj se kemi bërë edhe ne vetë është të mendojmë se mund të zgjidhet në mënyrë të standardizuar. Çdo rast është më vete: ka kohë të ndryshme kur ka ndodhur ngjarja, ka kontekste të ndryshme. Mbetet për t'u parë. Nga ana jonë po bëjmë çfarë duhet dhe edhe ju si media: rast pas rasti. Prokuroria sot vendimi i kalon në gjykatë, do ketë vendime publike. Mbetet për t'u parë arsyetimi.

Çdo vend ka kuadrin e vet ligjor, shpesh nuk mund të marrësh thjesht praktikën ndërkombëtare dhe ta transplantosh këtu. Do të shikojmë çfarë mungon, ku ka ngelur. Prandaj, këmbëngulja, mosheqja dorë nga procesi dhe qëndrimi afër janë thelbësore, për ta ndihmuar gjithë shoqërinë dhe çdo familje.

Fatmira Nikolli (News24): Cila prokurori prisni të jetë e para që ndërmerr hapin e parë?

Dr.Gentiana Sula: Shkodra dhe Mirdita kanë qenë më aktive deri tani për shkak të ndjeshmërisë historike. Në Shkodër janë figurat e klerit, figurat e rezistencës dhe elitës politike dhe familjet kanë qenë shumë aktive, Kisha shumë aktive dhe numri është i konsiderueshëm. Bashkia është në alert, e shoh që kanë pritshmëri të larta.

Mirdita vet është qyteti i dytë për nga përndjekja. Numri i personave të vrarë në rradhë është: Shkodra, Mirdita, Erseka dhe të treja janë të përfshira. Sidomos Mirdita ka katër figura historike të Revoltës dhe shoqëria është ndërgjegjësuar. Ka shkolla me emrat e heronjve të Revoltës. Janë relativisht vonë, por mendoj se konteksti historik ka peshë shumë.

Edhe historitë e kufirit të Ersekës janë vitet e vona, vitet '90 dhe aty ka ndjeshmëri. Por varet rast pas rasti do të shikohen dhe provat. Nuk dua ta paragjykoj. Ju lutem: mos flasim me skepticizëm dhe me të pamundurën. Çdo ngjarje meriton drejtësi. Çdo njeri, çdo familje ka të drejtë ta mbyllë këtë kapitull sepse ka vajtur gjatë.

AUTORITETI DHE AKADEMIA USHTARAKE NISIN BASHKËPUNIMIN: SIMPOZIUM PËR TË SHKUARËN DHE PARTNERITET PËR SIGURINË KIBERNETIKE E INTELIGJENCËN ARTIFICIALE

Tiranë, 17 prill 2026

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Akademia e Forcave të Armatosura po thellojnë bashkëpunimin institucional përmes një marrëveshjeje dypalëshe që synon zhvillimin e projekteve të përbashkëta në kërkimin shkencor, edukimin dhe inovacionin teknologjik.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, kryetarja e Autoritetit, Gentiana Sula, së bashku me ekipin e saj, zhvilloi një takim pune në ambientet e Akademisë së Forcave të Armatosura me drejtuesit e këtij institucioni: Gjeneral Bardhyl Nuredinaj, Komandant/Rektor; Prof. Asoc. Dr. Etleva Smaçi, Zv. Rektor; Kolonel Gjergji Vasili, ekspert IT; Dr. Blerina Kuqi, historiane dhe shefe e grupit të historisë; si dhe Jurgen Zavalani, jurist në AFA.

Nga ana e Autoritetit, në takim morën pjesë gjithashtu Drejtorja e Drejtorisë së Mbështetjes Shkencore dhe Hulumtimit, përfaqësues nga Drejtoria e Sigurisë dhe IT-së, si dhe ekipi i juristëve të institucionit.

Gjatë takimit u diskutuan fusha të reja bashkëpunimi dhe hapat konkretë për formalizimin e marrëveshjes dypalëshe. Një nga shtyllat kryesore të bashkëpunimit do të jetë organizimi i një simpoziumi shkencor të përbashkët, i fokusuar në shqyrtimin e figurave historike të ushtrisë shqiptare dhe analizimin e rolit të ish-Sigurimit të Shtetit në sektorin e

mbrojtjes gjatë periudhës 1944–1991.

Ky aktivitet synon të sjellë një qasje të thelluar akademike dhe të kontribuojë në pasurimin e debatit publik mbi të shkuarën.

Po ashtu, bashkëpunimi parashikon shkëmbimin e përvojave ndërinstitucionale në fusha të rëndësishme si siguria kibernetike, informatika dhe integrimi i inteligjencës artificiale në proceset e punës, duke synuar modernizimin e praktikave institucionale dhe rritjen e kapaciteteve profesionale.

Takimi shënon një hap konkret drejt ndërtimit të një partneriteti të qëndrueshëm mes dy institucioneve, në funksion të kërkimit shkencor, transparencës historike dhe zhvillimit teknologjik.

VIZITË E DEPUTETIT SAMIR KORESHI DHE GAZETARIT TË MEDIAS LOKALE SHKËLQIM BYLYKBASHI NË AIDSSH

Tiranë, 22 prill 2026

Deputeti Samir Koreshi dhe gazetari i medias lokale Shkëlqim Bylykbashi, një nga kontribuuesit aktivë në dokumentimin e historive të Lushnjës dhe komunitetit të saj gjatë periudhës së diktaturës u pritën në një vizitë pune në AIDSSH.

Në këtë kuadër, u diskutua edhe ekspozita fotografike “Historitë e patreguara të Lushnjës”, e bazuar në foto autentike të të internuarve në fshatrat e Lushnjës dhe bashkisë Divjakë. Si dhe në gjendjen e tyre sot, mbi 30 vite pas rënies së regjimit komunist. Përmes saj, u sollën në bisede histori ende të patreguara të kampeve të internimit, të njerëzve dhe vendeve, si dhe histori familjare që presin të zbulohen më tej.

Po ashtu, u ndanë ide për hapat e mëtejshëm drejt projekteve të muzealizimit, me synim ruajtjen dhe prezantimin e kësaj trashëgimie historike në mënyrë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, ku jo vetëm familjarët dhe ish-banorët e zonave të internimit, por edhe brezat e rinj të kenë mundësi të njohin dhe të kuptojnë këtë histori.

Nga ana e tij, deputeti Koreshi theksoi se do të vijojë të kontribuojë në rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional, edhe me pushtetin vendor, për të çuar përpara nisma në shërbim të kujtesës historike dhe edukimit qytetar.

“Kënaqësi të takoja deputetin Saimir Korreshi dhe Shkëlqim Bylykbashin, djalin e një të mbijetuarit të Spaçit. Diskutuam për përgjegjësinë tonë në ruajtjen e kujtesës historike, veçanërisht në Lushnje—një vend me peshë të madhe kombëtare. Nga reformat e dhunshme agrare të 11 fshatrat e internimit dhe Burgu i Kosovës për gratë e huaja, historia e Lushnjës është dëshmi i qëndrësës. Sot, ajo mbetet pikë takimi ku familjet rikthehen për të gjetur rrënjët e tyre. Këto histori janë identiteti ynë dhe meritojnë njohje e kujtesë publike” – tha Kryetarja e Autoritetit, Dr. Gentiana Sula.



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT

Adresa: Njësia Administrative nr. 4
Rruga "Kongresi i Manastirit", Garnizoni "Skënderbej", Tiranë